



# STEVE TURNER

KOMISIONERI I  
POLICISË DHE KRIMIN I  
CLEVELAND

## Plani im prej 10 Pikash për policimin dhe sigurinë e komunitetit

Si Komisioneri për Policinë dhe Krimin, nga unë kërkohet që të zhvilloj një plan për ta bërë Cleveland një vend më të sigurt për ata që jetojnë, punojnë dhe vizitojnë këtë zonë. Plani im prej 10 pikash, i cili është hartuar në bashkëpunim me ekspertë të krimit dhe sigurisë së komunitetit, paraqet vizionin tim për tre vitet e ardhshme.



### Sjellja e autorëve të veprave penale para drejtësisë

Rritja e mundësive që autorët e veprave penale të mbajnë përgjegjësi për sjelljen e tyre duke u fokusuar në parandalimin e përsëritjes së veprës penale.



### Luftë e rreptë kundër drogës dhe bandave

Prezantimi i një metode holistike ndaj drogës dhe bandave, duke përfshirë parandalimin, ndërhyrjen e hershme dhe të synuar.



### Luftimi i sjelljes antisociale ballë për ballë

Mbajtja e një qëndrimi të vendosur ndaj sjelljeve antisociale duke punuar në partneritet dhe duke angazhuar të rinjtë.



### Sistemi efektiv i drejtësisë penale

Bashkëpunimi dhe kërkesa e llogarisë ndaj Policisë së Cleveland dhe agjencive të Drejtësisë Penale në përgjithësi, për të rritur besimin e publikut.

Tel: 01642 301213

E-mail: [pcc@cleveland.pnn.police.uk](mailto:pcc@cleveland.pnn.police.uk)

Faqja e internetit: [www.cleveland.pcc.police.uk](http://www.cleveland.pcc.police.uk)





## Parandalimi, zvogëlimi dhe lufta kundër dhunës së rëndë

Zhvillimi i një Strategjie për të luftuar Dhunën e Rëndë në bashkëpunim me Policinë e Cleveland dhe Partneritetet e Sigurisë në Komunitet.



## Më shumë policë në rrugët tona

Investim në reagimin e komunitetit në vijën e parë.



## Lufta kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave

Punë në partneritet me shërbimet lokale për të siguruar që gratë të ndjehen të sigurta dhe të mbështetura.



## Ndërtimi i besimit në komunitetet tona

Të siguroj që Policia e Cleveland-it të ofrojë shërbime me cilësi të lartë, duke rritur krenarinë dhe mbështetjen për policinë në të gjithë zonën tonë vendore.



## Mbështetje efektive me cilësi për viktimat dhe dëshmitarët

Ofrimi i ndihmës për viktimat dhe dëshmitarët nëpërmjet caktimit të shërbimeve të specializuara mbështetëse.



## Përdorimi i teknologjisë për të luftuar krimin

Maksimizimi i përdorimit të teknologjisë, duke krijuar mundësi për efikasitet dhe mbështetje shitesë për fuqinë punëtore.

## Ky plan do të ndihmojë në përmbushjen e katër qëllimeve të mia strategjike për Cleveland:



Për të ndërtuar besimin e publikut dhe për të rikthyer krenarinë për Policinë e Cleveland.



Të punojmë së bashku me partnerët për të reduktuar krimin, në mënyrë specifike dhunën e rëndë.



Për të përdorur më shumë teknologjinë që krijon efikasitet dhe mbështet produktivitetin.



Viktimave dhe personave më pak të mbrojtur t'u ofrohen shërbime të cilësisë së lartë të cilat përmbushin në mënyrë efektive nevojat e tyre.



Skanoje për të shkarkuar planin e plotë!

